




Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626-26-5150-5-2-1

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullave dhe udhëzuesit të Prokurimit Publik-NDRYSHIM / PLOTESIMIT të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01 neni 43 pika 43.6 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika b dhe neni 7 paragrafi 7.1 a), bie këtë :

V E N D I M

I

Hudhet e papranuar ,Kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik I POWER KOSOVA ASHPK nga **Suhareka me numer biznesi 811033141** " e parashtruar me datën 03.08.2026 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-26-5150-5-2-1 dhe nr. 626-26-015-5-2-1 të brendshëm: me titull "RENOVIMI I ASFALTIMIT DHE KUBEZAVE NE RRUGET KISLA-CUMHURIYET-BAHCELIK-HURIYET PASA-ASCER-DEMIRCI-KLIQKA DHE KULTUR-RRUGET ANESORE TE PA EMERTUARA"

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

- **Ankesa është në fazën e tenderimit (para dorzimit të ofertave) dhe kërkesat e Pretenduara janë për të gjitha paisjet e kërkuara në dosje të tenderit ,për të ju dhene arsyet pse nevoiten ato paisje , që ekluziviteti i paisjeve është i pershkruar në të dhenat e paisjeve , që për A.K . duke parë punët që do të jenë objekt i kesaj kontrate janë të specifikuar gjithësecila**

- O.E sipas kërkeses per sqarim dhe tani ne Kërkesen per shqyrtim "konsideron" se nuk kane qene te nevojeshme kërkesat per ato paisje , duke shfletuar qe te gjitha dhe kërkesen per te arsyetuar A.K . se Cfare pune kryejn ato paisje .
- O.E . duhet te dije se natyra e puneve ne kete projekt eshte renovim dhe sanime sipas nevojave ne rrugicat e paemertuara qe lidhen me rruget kryesore te potencuara ne titull. Eshte edhe fakti tjetër se kontrata eshte per njesi (nje) gje qe apriori nuk dihen nevojat gjate periudhes se kontrates prej 36 muajeve .
- O.E. e di qe LPP ka mundesuar Krijim te grupit te O.E .per te mundur per tu paisur me paisjet qe i mungojne apo edhe marrje ne shfrytezim qe jane te lejuara me ligj.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues bazuar ne nenin 109 te LPP

04.08..2026 **Në M a m u s h ë**

Abaz Foniqi Dreejtor i Drejtorise së Prokurimit Komuna e Mamushës

